



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

Nr. 67 Prot

Tiranë, më 12.12. 2011

VENDIM Nr. 10 dt. 09.12.2011

Në mbështetje të nenit 17, pika 6, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, ndryshuar me ligjin nr. 9882, dt 28.02.2008, "Për Trashëgiminë Kulturore", Këshilli Kombëtar i Restaurimeve në mbledhjen e datës 09.12.2011, pasi shqyrtoi projektet e diskutuara në Institutin e Monumenteve të Kulturës, sipas pikave të rendit të ditës:

VENDOSI:

Lidhur me:

I. Diskutimi i kërkesave të qytetarëve:

1. **Miratohet:** Projekt për restaurimin, rigjallërimin dhe rivlerësimin e kalasë së periudhës mesjetare në Lezhë.
2. **Miratohet:** Rikonstruksion i podrumit dhe rindërtim i dyqanit të rrënuar, në rrugën "Pirro Lera", nr.10, pjesë integrale e bllokut të dyqaneve nr.18 të Ansamblit muzeal të pazarit të Korçës, me pronar z. Stavri Kallço.
3. **Miratohet:** Projekt i banesës individuale dhe shërbim 3 kate + podrum me investitor Gjergji Grabocka, rruga Niko Dodona, Korçë.
4. **Miratohet:** Rikonstruksion i banesës në rrugën "Niko Dodona", pjesë integrale e bllokut të banesave në lagjen nr.12 me pronar z. Gëzim Zeneli, Korçë. (Miratohet varianti i trajtimit të ballkoneve vetëm me kangjella).
5. **Miratohet:** Projekt i banesës individuale dhe shërbim 3 kate + podrum me investitor Gaqo, Flora, Erion, Dorian Marku, rruga Sofokli Maliqari, Lagja 2, Korçë.

6. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe shtesë kati e banesës me investitor Petrika Çekani, rruga Mihal Grameno, Korçë.
7. **Miratohet:** Rikonstruksion i banesës në rrugën “Jani Dudo”, pjesë integrale e bllokut të banimit, të lagjes nr.1 me pronar z. Edvin Pallanguri, Korçë.
8. **Miratohet:** Projekt rikonstruksioni dhe shtesë anësore 3 kate me bodrum + shtesë kati 44% mbi objektin ekzistues, investitor Jeta Spiro Ravoniku dhe Serafin Nico, Korçë.
9. **Miratohet:** Projekt i objektit tregtar dhe banim 3 kate me podrum, investitor Nikollaq Riza, bulevard “Republika”, Korçë.
10. **Nuk u diskutua:** Projekt ndërtimi i kompleksit të banimit dhe shërbimit 2,3, kat, rruga Skënderbeg, Shkodër, me porositës Shefik Dibra.

- Ngarkohet sekretaria teknike, për njoftimin e këtij vendimi.
- Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R
ALDO BUMÇI



SEKRETAR I KKR
AKADEMIK. APOLLON BAÇE

